

VLERESIM PARAPRAK I NDIKIMIT NE MJEDIS

OBJEKTI:

"Ndertim i rrjetit te ujesjellesit zona Industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit)" dhe linjes se dergimit, Bashkia Berat "

A.Ndertim i rrjetit te ujesjellesit zona Industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit)

B.Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat

POROSITES:

UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT-KUÇOVË sh.a

PROJEKTUES:

BOE: "KKG PROJECT" sh.p.k & "LEAD CONSULTING"

sh.p.k & "IDEAL Design & Services" sh.p.k

Perfaqesues

Ing. Ardit KANE

Raport i Vlerësimit Paraprak i Ndikimit në Mjedis për projektin:

A.Ndertim i rrjetit të ujësjes së zonës industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit)

B.Ndertim i Linjes së Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat

Bashkia Berat

*Klasifikimi i Vlerësimit Paraprak i Ndikimit në Mjedis, mbështet në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011
“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, sipas shtojcës II, pika 10/Prodhime Infrastrukturore: g)
Instalime të kanaleve ujësues/akuedoteve në distanca të largëta;*

Pergatitur nga: *Sonila Llupo Gogu*

Eksperte Mjedis

Olgert Gjika

Ekspert Mjedis

Subjekti aplikues: *UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT-KUÇOVË
sh.a*

Ndertim i rrjetit të ujësjes së zonës industriale Bera
Ndertim i Linjes së Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat

Bashkia Berat

1

Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis
Olgert Gjika, Ekspert Mjedis

2022

Ky raport i Vleresimit Paraprak te Ndikimit ne Mjedis vlereson nga pikepamja mjedisore dhe sociale projektin per furnizimin me uje te zones industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit), linjës së dërgimit Depo nr.1 – Depo Kombinat, te ndodhur ne Bashkine Berat. Parametrat baze te projektimit jane adoptuar me modifikimet ne lidhje me madhesine e rrjetit shpernadres.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës në Bashkine Berat.

Ndertim i rrjetit te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	2
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

Përmbatja e studimit

1. Hyrje	17
1.1 Qellimi dhe objektivat e vlerësimit të ndikimit në mjedis	17
1.2 Metodologjia e hartimit të VNMsë	18
1.3 Kuadri ligjor	18
2. Mbulesa bimore në zonën e projektit të propozuar	20
2.1 Zonat e mbrojtura dhe monumetet e natyres	21
2.2 Informacione për praninë e burimeve ujore	22
3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	23
3.1 Vlerësimi i ndikimeve në ajër	24
3.2 Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit.....	24
3.3 Ndikimi në cilësinë e ujrave sipërfaqësore	25
3.4 Zhurmat	26
3.5 Peisazh.....	26
3.6 Mbetjet	26
3.7 Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit	27
4. Shkarkimet e mundshme në mjedis	28
4.1 Ujëra të ndotura	28
4.2 Gaze dhe pluhur	28
4.3 Zhurma	28
4.4 Vibre.....	30
4.5 Shkarkimi i mbetjeve	30
5. Kohezgjatja e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar.....	31
5.1 Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve mjedisore	31
6. Shtrirja e undshme hapësinore të ndikimit në mjedis	33
6.1 Perhapja e pluhurave në ajër	33
6.2 Perhapja e mbetjeve në zonë	33
6.3 Perhapja e ndotesve në ujrat sipërfaqësore	34
6.4 Perhapja e zhurmave në mjedis.....	34
7. Rehabilitimi i mjedisit.....	34
8. Masat zbutëse të ndikimeve negative në mjedis	34

8.1 Masat zbutëse të ndikimeve që ndikojnë në cilësinë e ajrit	35
8.2 Masat zbutëse të ndikimeve që ndikojnë në cilësinë e tokës	35
8.3 Masat zbutëse të ndikimeve që ndikojnë në cilësinë e ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësore.....	35
8.4 Masat zbutëse për ndikimet që ndikojnë në cilësinë e florës	36
8.5 Masat zbutëse për ndikimet ndaj vibrimeve.....	36
9. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar.....	37

Lista e figurave

Figura 1: Distanca e zones se projektit nga Parku Kombetar I Tomorit.....	22
Figura 2: Lumi Osum trupi uJOR kryesor i qytetit te Beratit.....	23

Lista e tabelave

Tabela 1: Kodet e mbetjeve që priten të gjenerohen.....	27
Tabela 1: Vlerat më të larta të lejuara në punimet ndërtimore- Surrey County Council	29
Tabela 2: Niveli i zhurmave.....	29
Tabela 3: Kodet e mbetjeve që priten të gjenerohen.....	30
Tabela 4: Vleresimi I ndikimeve mjedisore faza ndertimore.....	32

Ndertim i rrjetit te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	4
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedisi Olgert Gjika, Ekspert Mjedisi	2022	

Përkufizime¹

“**Zhvillues**” është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik. E drejta e aplikimit të këtij raporti të Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis është e bashkë të Berat.

“**Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)**” është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

“**Vendim**” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

¹ Referuar Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ndertim i rrjetit të ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes së Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	5
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

1. Hyrje

Ky raport i vleresimit të ndikimit në mjedis është hartuar në bazë të raportit të projektimit për objektet si më poshtë të ndodhura në Bashkinë Berat :

- i) Ndertim i rrjetit të ujesjellesit zona Industriale (ish rezervat e shtetit-Ura e Hanit)*
- ii) Ndertim i Linjes së Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat*
- iii) Rikonstruksioni i sallës së komandimit të Depos së ujit Kombinat*

Pas takimeve dhe diskutimeve gjithëpërfshirëse me përfaqësues të Njesive Administrative dhe Bashkise Berat si dhe përfaqësuesve të Ujesjelles Kanalizime Berat-Kuçove, janë shfrytëzuar të dhenat e vëna në dispozicion. Parametrat bazë të projektimit janë adoptuar me modifikimet në lidhje me madhësinë e rrjetit shpërndarës.

Qëllimi i përgjithshëm është të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës në Bashkinë Berat, në përmirësimin e furnizimit me ujë të banorëve, duke ndërtuar linjë të reja shpërndarëse si dhe vendosja e matësve të ujit në çdo abonent për pakesimin e humbjeve. Me konkretisht ky objekt projektimi në teresi konsiston në:

- 1. Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të popullsisë së kësaj zone me rreth 288 banorë, 71 biznese, 5 institucione, duke ndërtuar linjë të reja shpërndarëse, vendosja e matësve të ujit në çdo abonent për pakesimin e humbjeve si dhe prerja e linjave informale ekzistuese.*
- 2. Ndërtimin e linjes së dergimit Depo nr 1-Depo Kombinat.*

1.1 Qëllimi dhe objektivat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është një proces që ka si qëllim kryesor identifikimin e pasojave në mjedis, sociale dhe ekonomike të një projekti para vendimarrjes për zbatimin e tij. Nepermjet VNM realizohet mbrojtja e mjedisit qysh në fazën e hartimit ose dizenjimit të projektit, gjenden rrugë ose mënyra për të zvogëluar ndikimet negative, propozohen alternative ose zgjidhje të tjera për vendimarrësit.

Qëllimi dhe objektivat e VNM mund të ndahen në dy kategori.

Qëllimi i parë, drejtperdrejtë, është të informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar si të konsiderueshme e potenciale në mjedis dhe rreziqet e përfitimet e projektit dhe zhvillimit të propozuar.

Qëllimi i fundimtar, afatgjatë i VNM është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që propozimet e projektit nuk prekin burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mirëqenien, stilin e jetesës dhe jetesën e komunitetit si dhe të njerezëve që lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe të drejtperdrejte të VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjane termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;

1.2 Metodologjia e hartimit te VNMsë

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte kerkese e legjislacionit vendas per te siguruar menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Projekti per prodhimin e energjise nga rrezatimi djellor nepermjet paneleve diellore eshte pjese e ketij legjislacioni. Ky studim mbështet në kërkesat e Vendimit nr. 686 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, kreu I.

Hapat kryesorë që janë ndjekur gjatë procesit të hartimit të raportit të VNMsë, janë;

1. Njohja me projektin teknik, i cili eshte vendosur ne dispozicion nga grupi i projektimit;
2. Njohja dhe percaktimi i kerkesave ligjore per projektin;
3. Njohja me karakteristikat e vendndodhjes se projektit;
4. Vizite ne vendodhjen e projektit per tu njohur me nga afer me karakteristikat e mjediit ekzistues, si; bimesia, distancat me qendrat e banuara, infrastruktura, trupat ujor, etj;
5. Mbledhja e te dhenave dhe hartimi i raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis;

1.3 Kuadri ligjor

Bauar në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”²,

I cili ka për qëllim të sigurojë:

- a. një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b. garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

² I ndryshuar

Ndertim i rrejtit te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	18
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

Neni 4, kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.
2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
4. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Kreu II, *neni 7*, “Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

Klasifikimi i raportit të VNM-së bazohet në shtojcat I dhe II të veprimtarive të përcaktuara në shtojcat e ligjit të VNM-së.

Neni 8, projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) *projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur ligjit të VNM-së*

Neni 9, procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen:

- a) *projektet e listuara në shtojcën I;*

Projekti në studim është objekt i **ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, shtojca II, pika 10/Prodhime Infrastrukturore: g) Instalime të kanaleve ujësjellës/akuedoteve në distanca të largëta;**

Për ndërtimin e strukturës dhe përmbajtjes së raportit paraprak të VNM-së bazohemi në **Vendimin Nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, kreu I.**

Referuara vendimit nr.686, kreu II, dokumentat për të aplikuar janë:

- Raporti teknik

Ndertim i rrjetit te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	19
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

- Raporti paraprak i VNM-së
- Akt regjistrimi i kompanisë
- Kërkesa
- Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit

Tarifa e shërbimit për shqyrtimin e kërkesës nga Ministria e Mjedisit përcaktohet në udhëzimin nr.7938, datë 17.07.2014 “për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”.

Ligji nr. 10431 datë 10.03.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqëve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vëndit.

Ligjet bazë	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011	Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis <i>I ndryshuar</i>
Ligji Nr.10453 datë 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura <i>I ndryshuar</i>
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmes
Vendime	
Nr. 686 datë 29.07.2015	“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, kreu I.
Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse
Nr.435 datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë

2. Mbulesa bimore ne zonen e projektit te propozuar

Projekti zhvillohet brenda zones se banuar te qytetit te Beratit, ne pjesen veriore te tij. Kjo zone prej dekadash ka patur nje orientim industrial, ku ndodheshin kombinati i tekstitit, fabrikat per

Ndertim i rrejtimit te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	20
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

prodhimin e produkteve ushqimore. Ne kete zone industriale para vitit 1990 ishte e ndalur ndertimi i godinave me qellim banimi, me pas kjo zone u urbanizua.

Nga pikepamja ekologjike paraqet nje mjedis mozaik ku godinat industriale bashkohen me banesat e ndertuara me qellim banimi.


Kodrat perreth paraqesin nje habitat tipik bujqesor per arsye se ato jane kthyer ne taraca dhe jane krijuar platacione me ullinj.

2.1 Zonat e mbrojtura dhe monumetet e natyres³

Në lindje të territorit të bashkisë së Beratit ndodhet një pjesë e parkut kombëtar të Tomorit. Zona e projektit nga mali i Tomorit është në vije ajrore afërsisht 12 km. Ai ka një shtrirje në dy qarqe të vendit (Berat dhe Elbasan) me një sipërfaqe 24,723 ha. Parku ka biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Flora e parkut është shumë e pasur, ku përmendim ahun, robullin dhe pishën e zezë, kullotat subalpine dhe alpine, si dhe një faunë të larmishme kryesisht për gjitarët e mëdhenj (ariu-Ursus arctos, ujku-Canis lupus, shpendë grabitqarë të ditës dhe të natës, etj.). Zonat e mbrojtura në bashkinë e Beratit janë: • Parku Kombëtar “Mali Tomorit”, kategoria e dytë sipas IUCN;

- Biomonumentet, kategoria e tretë sipas IUCN;
- Gjeomonumentet, kategoria e tretë sipas IUCN. Rreth 8,398.4 ha të zonës së Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit ndodhet në Berat.

Mali i Tomorit arrin lartësinë maksimale në majën e quajtur Cuka Partizan e cila ndodhet 2,416 m mbi nivelin e detit. Kurrizi i malit dallohet për një përbërje karstike gëlqerore. Përveç pyjeve të shumta, në brendësi të parkut, në Qafën e Kulmakut gjendet Teqeja e Abaz Aliut. Kjo teqe është vend pelegrinazhi për besimtarët bektashinj, kryesisht në Gusht, pavarësisht infrastrukturës së varfër rrugore për të arritur në destinacion. Në park ndodhet edhe subjekti i ambalazhimit të ujit të pijshëm i quajtur “Bora”.



³ https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00W756.pdf

Ndertim i rritjes te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	21
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

Figura 1: Distanca e zones se projektit nga Parku Kombetar I Tomorit

Sipas ARM-së, parku dallohet për larmi të faunës dhe florës falë lartësive të ndryshme dhe mikroklimeve të krijuara. Bimësia përfshin nga shkurret, dushkajat, pyjet e ahut, lisit, rrobullit (në lartësi 1600 m mbi nivelin e detit), pyje të përziera, pyje të pishës dhe kullotave të cilat shtrihen në kreshtën e malit. Fshatrat dallohen për pyje me bimësi të ndryshme. Në disa vende ndodhet edhe panja e malit (acer pseuplatanus) dhe pisha e zeze (*Pinus nigra*). Pyjet dallohen edhe për një nënpyll të pasur të përbërë kryesisht nga frashri, vadhëza, lajthia, molla e egër, kulumbria, dëllinja e kuqe e rrallë e zezë etj. Parku ka një botë të pasur shtazore, që përbëhet nga gjitarë të mëdhenj si ariu, ujku, dhelpra dhe kunadhja, dhia e egër, baldosa, lepuri i egër, ketri, nuselale, etj. Nga shpendët dallohen thëllëza e malit, gjeli i egër trupvogël, shqiponja, skifteri, disa lloj qukapikësh, pëllumbi i egër, shapka, mëllenja, guhak, grifsha, cërrila e malit dhe lloje të ndryshme zogjsh. Në park ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj e nepërka. Një nga zonat me faunë të pasur është dhe ajo e Velabishtit.

Por gjatë 15 viteve të fundit fauna ka pësuar dëme për shkak të prishjes së habitateve nga gjuetia pa kriter. Në territorin e pyjeve dhe kullotave në këtë komunë gjenden një larmi e kafshëve dhe shpendëve të egër të llojeve të ndryshme, si lepuri, dhelpra, thëllëza dhe qukapiku, laraska, grifsha dhe mëllenja.

Në bashki numërohen 6 monumente të natyrës:

- Lisi i Çezmës së Prokopisë-Paftal
- Rrapi Lybeshës
- Rrapi Veleshnjës
- Ulliri Drobonikut në Palikesh
- Rrapi Burimit-Paftal

Një pasuri tjetër natyrore janë dy grumbujt pyjorë-Pylli i Kulajve, Velçan dhe Gështenjat e Mimiasit. Ndër gjeomonumentet përmendim shpellat e Shahinovës dhe Kapinovës, antiklinalin e Beratit, malin e Tomorit dhe antiklinalin e Shpiragut, etj. Informacioni për zonat e mbrojtura dhe bio/gjeo monumentet është relativisht i varfër dhe nevojitet që këto fenomene e pasuri të bëhen të njohura për banorët. Kjo do të shmangë dëmtime të mundshme. Po ashtu, në kuadër të zhvillimit të turizmit, territori mund të pajiset me shenja orientuese/informuese për të gjitha këto 2.1 kategori. Numri i punonjësve për menaxhimin e zonave të mbrojtura është tejet i vogël në lidhje me numrin e vizitorëve që i frekuentojnë ato (sidomos parkun e Tomorit), gjë që përbën problem për ruajtjen e zonave të mbrojtura. Nga pikëpamja peizazhistike, Berati ka një matricë të pasur natyrore dhe me efekte dramatike si rezultat i ndryshueshmërisë së relievit.

2.2 Informacione per praninë e burimeve ujore

Bashkia Berat ka një rrjet të pasur hidrik. Lumi i Osumit përbën boshtin kryesor të këtij rrjeti i ndjekur nga Përroi i Molishtit. Osumi (rrjedha e mesme e tij) përkrah territorin e Bashkisë së Beratit përgjatë 21 km nga pjesa jug-lindore në Malinar deri në Moravë në veri ku lumi del nga bashkia drejt Urës Vajgurore. Osumi buron në zona të larta dhe sjell me vete të gjithë erozionin e grumbulluar gjatë rrjedhës së tij të sipërme. Nga degët e Osumit mund të përmenden lumi Zagoria me të cilin bashkohet në Uznovë, përroi Gushtavë dhe përroi Lapardha (në anën e

Ndertim i rrjetit të ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes së Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	22
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedisi Olgert Gjika, Ekspert Mjedisi	2022	

djathhtë të lumit). Në anën e majtë, Lumi Osum merr me vete Lumin Molisht, afër Velabishtit, i cili buron jashtë territorit të bashkisë. Përroi i Molishtit hyn në Bashki në Veleshnjë në jug, përshkon territorin e bashkisë drejt Gjerevenit dhe bashkohet me Osumin afër Urës së Re, Berat. Përveç Osumit, Bashkia ka dhe një numër të madh rezervuarësh të shpërndarë nëpër fshatra. Ndër ta dallohen rezervuari ndërmjet Sinjës dhe Mbolanit, rezervuari i Mbjeshevës në perëndim të Shpiragut, i Mreshtanit, rezervuari ndërmjet Kamçishtit e Gjrovenit, rezervuari ndërmjet Vodëzës së Sipërme e Qereshnikut, ai i Roshnikut, dhe rezervuari në Perëndim të Qafë Dardhës.



Figura 2: Lumi Osum trupi ujqor kryesor i qytetit te Beratit

3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Çdo aktivitet njerëzor mbi mjedisin natyror shkakton ndikime të ndryshme mbi të, i cili mund të jetë i vogël ose i madh, mund të jetë pozitiv apo negativ, i drejtpërdrejt apo i tërthortë. Për të vlerësuar karakterin e ndikimit, të përmasave dhe faktorët e mjedisit mbi të cilin ushtrohen ndikimet është e nevojshme hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimeve Mjedisore (VNM). Qëllimi kryesor i VNMsë është që vlerësimi i çdo aktiviteti njerëzor mbi mjedis të arrihet pas një studimi i cili ka patur si qëllim kryesor menaxhimin sa më të mirë të burimeve natyrore. Ndikimet që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të burimeve natyrore të shmangen nëse është e mundur dhe nëse jo, niveli i ndikimit mbi mjedis të jetë i ulët. Në seksionet e mëposhtme janë paraqitur çështjet kryesore të cilat do të meren në vlerësim nga zhvillimi i projektit në fazat e mëposhtme:

Ndertim i rrejtës së ujës së zonës industriale Bera Ndertim i Linjes së Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	23
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedisore Olgert Gjika, Ekspert Mjedisore	2022	

- *Ndikimet në fazën e ndërtimit:* Në këtë fazë do të vlerësohen ndikimet të cilat vijnë nga zbatimi i punimve ndërtimore, si, përgatitja e sheshit, instalimi i paneleve dhe lidhja me sistemin inxhinierik.
- *Ndikimet nga faza e funksionimit:* Në këtë fazë afatgjate do të analizohen ndikimet në cilat vijnë nga prodhimi i energjisë nga rrezatimi djellor.

3.1 Vleresimi i ndikimeve në ajër

Per zbatimin e projektit te shtrimit te rrjetit te ujesjellesit, aktivitet e para ndërtimore që ndërmerren, perfaqesojnë një nga fazat të cilat ndikojnë në cilësinë e ajrit. Faktorët që ndikojnë në cilësinë e ajrit është emetimi I gazeve dhe grimcave të ngurta në ajër.

Gjatë fazës ndërtimore, burimi i këtyre faktorëve negative ndikues janë lëvizja e automjeteve dhe zhvillimi I aktiviteteve ndërtimore, hapja e kanaleve per shtrimin e tubacioneve. Nga studimet mjedisore per hapjen e kanaleve dhe te punimeve germuese ne pergjithesi, është llogaritur që sasia e pluhurit që mund të përhapet në atmosferë gjatë 8 orëve të punës në pesë ditë të javës është 0.35 kg/h që i përkët 0.7g/s (PM10). Kjo sasi e llogaritet edhe në bazë të kushteve klimatike, në ditët e lagta kur toka është e lagur sasia e pluhurit që përhapet është me e vogël. Në ditët kur punimet janë intensive dhe kushtet klimatike normale pluhuri mund të përhapet deri 150m nga vend i punimeve.

Burimi kryesor i emetimit të gazeve dhe të grimcave të ngurta do të jetë lëvizja e automjeteve të rënda të transportit por edhe ato fikse. Emtimi I gazeve NOx, CO, SO2 etej, do të shkaktohen si rezultat i djegies së brëndëshme në këto automjete të lëvizëshme. Ndërsa grimcat e ngurta shkaktohen dhe përhapen në atmosferë nga proceset e ndryshme ndërtimore dhe nga lëvizja e automjeteve në rrugë jo të asfaltuara dhe nga ndotja e rrotave te automjeteve në këto mjedis ndërtimore.

Përsa i përket edhe nivelit të ndotësve që emetohen në ajër, vlerësohet të jetë I vogël. Sasia e grimcave të ngurta vlerësohet të jetë e vogël për arsye se koha e punimeve është e shkurtër, lëvizja e automjeteve gjithashtu vlerësohet të jetë e vogël dhe nese do të zbatohen të gjitha masa zbutëse që propozohen në këtë studim ky lloj ndikimi do të jetë I pa përfillshëm. Duke u bazuar në kohëzgjatjen, nivelin dhe kthyeshmërinë e këtij lloj ndikimi, nuk do të jetë I rëndësishën dhe kumulativ në mjedis.

Faza e funksionimit

Rrjeti i ujesjellesit eshte nje projekt infrastrukturor, nuk operon dhe nuk shkakton asnje lloj ndikimi negative ne mjedis. Ky projekt eshte I domosdoshem dhe jetik per banoret e qytetit te Beratit.

3.2 Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit

Toka është indikator i abiotik në të cilin ndikimet që mund të shaktohen nga implementimi i projektit te ujesjellesit janë të drejt-përdrejta. Për zbatimin e ketij projekti, punimet e para ndërtimore që do të ndërmeren janë:

Ndertim i rrjetit te ujesjellesit zona industriale Bera Ndertim i Linjes se Dergimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	24
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedisi Olgert Gjika, Ekspert Mjedisi	2022	

- Hapja e kanaleve te gjurmes se rrjetit
- Shtrimi i tubacioneve te ujesjellesit
- Montimi i aparateve matese
- Rehabilitimi i depos se ujesjellesit

Nga aktivitetet ndërtimore që u përmëndën më lart ndikime që mund të shkaktohen dhe që mund të ndikojnë në cilësinë e tokës janë nga derdhjet aksidentale të lëndëve djegëse nga automjetet. Ky lloj ndikimi është plotësisht I menaxhueshëm. Gjatë këtyre aktivitetëve nuk do të përdoret asnjë lloj përbërje kimike e cila do të rrezikonte cilësinë e tokës. Punimet e germimit nuk shkaktojnë ndikime në karakteristikat fizike të zonës. Gjithashtu përveç tubacionit PVS nuk janë të nevojshme lende të tjera të para. Hapja e kanaleve realizohet me punime mekanike nga punetoret por edhe edhe me ndihmen e mjeteve ndërtimore.

Gjate fazes se ndertimi kontraktori i punimeve do të mënaxhojë cdo lloj mbetje urbane dhe jo vetem duke I grumbulluar në vende të caktuara. Referuar vleresimeve të tjera, në kantieret e ndërtimit gmbetjet urbane që gjenerohen nga punëtorët janë 0.75 kg/punëtorë. Mëqënëse numri i punëtorë nuk është shumë i madh rrjedhimisht edhe sasia e mbetjeve nuk do të jete e madhe. Gjithashtu do të vendosen tualete kimike me qellimin e shërbimit sanitar të punetoreve. Kontraktori duhet të vendosa kosha të levishem në terren me qellim menaxhimit e cdo lloj mbetje qe do të gjenerohet.

Duke u bazuar në analizën e më sipërmë cilësia e tokës dhe qëndrueshmëria e saj nuk ndikohen nga aktivitetet që do të realizohen gjatë fazës ndërtimore.

Faza e funksionimit

Rrjeti i ujesjellesit është një projekt infrastrukturor i cili nuk shkakton asnjë lloj ndikimi në mjedis për kundërsi është tepër jetik për banoret e zonës.

3.3 Ndikimi në cilësinë e ujrave sipërfaqësore

Punimet ndërtimore që do të ndërmerren në fazat fillestare (punimet ndërtimore janë përmendur në projektin teknik) janë punime që nuk ndikojnë në ujrat sipërfaqësore sepse punimet ndërtimore janë të llojit që nuk gjenerojnë ndotes. Gjurma e projektit ndodhet larg trupave ujor, lumit të Osunit.

Faza ndërtimore përfshin punime ndërtimore të thjeshta dhe nuk do të përdoren lende të para të rrezikshme për cilësinë e ujrave sipërfaqësore. Gjate këtyre procesve nuk do të gjenerohen mbetje të rrezikshme të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ujrave. Prandaj gjurmat e projektit do të vendosen tualete kimike dhe menaxhimi i tyre do të jete nëpërmjet kompanive të lincesuara.

Faza e funksionimit

Rrjeti i ujesjellesit është një projekt infrastrukturor i cili nuk shkakton asnjë lloj ndikimi në mjedis për kundërsi është tepër jetik për banoret e zonës.

Ndërtim i rrjetit të ujesjellesit zona industriale Bera Ndërtim i Linjes së Dërgimit Depo Nr.1- Depo Kombinat	Bashkia Berat	25
Punoi: Sonila Llupo Gogu, Eksperte Mjedis Olgert Gjika, Ekspert Mjedis	2022	

3.4 Zhurmat

Faza ndertimore

